



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 171 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmanji anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 14.06.2012, rreth orës 14:30 në Kaçanik, në motelin mbi kalanë i cili sipas parashtruesit të ankesës është pronë publike dhe për më tepër më një pjesë të ambientit të kalasë e cila është monument kulturor, militantët e LDK-së kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre për kryetar të komunës së Kaçanikut Sahit Bela. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 15.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00.

PZAP, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme për faktin se posteri në fjalë nuk është i vendosur në Kalanë e qytetit por në objekt të hotelit i cili nuk është pronë publike siç është theksuar nga parashtruesi i ankesës. Me propozimi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se militantë të subjektit politik LDK, kanë vendosur posterat e kandidatit të tyre për kryetar komune në hapësirat publike. PZAP-i gjeti se pretendimet e tillë ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tillë ankimore sepse nga fotot e ofruara si prova që gjendet në shkresat e lëndës nuk shihet qartë dhe nuk mundë të identifikohet objekti në fjalë për të cilin pretendon pala ankuese, prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si përgjithshëm dhe i pabazë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 171 /2012 më datën 18.06.2012.

Kryesuesi i Panelit  
Vlastimir Dimić

